



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.1010/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik N.N.Sh “Korben” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve” me nr.prokurimi 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna e Gjakovës”, më datën: 24.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve” me nr. prokurimi 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna e Gjakovës”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve” me nr.prokurimi 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna e Gjakovës”, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk-Gjakovë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupit i operatorëve ekonomik N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk-Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt. 26.11.2020 me nr. 1010/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve” me nr. prokurimi 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –“Komuna e Gjakovës”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenin 27 të RRUOPP-së, Interpretimin e KRPP-së të datës 10.09.2020, si dhe nuk e ka respektuar as vendimin e OSHP-së me nr. 719/20 të datës 29.10.2020.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 14.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1, Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar përsëri ofertën e tyre me arsyetimin se në formularin për dorëzimin e tenderit lider i grupit është OE N.T.SH “Marash Shped” Shpk, ndërsa në deklaratën e grupit është specifikuar që lideri i grupit është OE “Company Zuka Commerce” dhe pas ndryshimit të liderit sipas vlerësimit të AK-së lideri i grupit (N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe

referenca të realizuara ku është kërkuar që lideri duhet ti ketë 60 % të vlerës së kontratave të realizuara prej së paku 300,000.00 € në tri vitet e fundit, që sipas OE ankues në deklaratën për themelimin e grupit të OE shumë qartë është theksuar që lider i grupit është OE “Company Zuka Commerce” Shpk dhe AK nuk ka bërë rivlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, nenit 27 të RRUOPP-së dhe vendimit të OSHP-së, PSH.nr.719/20, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.719/20 të datës 29.10.2020, citoj “Paneli shqyrtues sqaron se pas administrimit dhe shqyrtimit të provave ka gjetur se grupi OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk së bashku më dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe Akt marrëveshjen për themelimin e grupit të OE në të cilën është specifikuar që Lider i grupit është OE “Company Zuka Commerce” Shpk ndërsa OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk është anëtar i grupit. Bashkangjitur me dokumentacionin në sistemin e e-prokurimit grupi i operatorëve ekonomik kanë dorëzuar edhe një autorizim të vulosur dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e konzorciumit në të cilin është theksuar që Albert Bala (përfaqësues i anëtarit të konzorciumit N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk) autorizohet për të nënshkruar dhe dorëzuar dosjen e tenderit apo për të ofruar informata shtesë mbi atë apo nëse shpallet fitues edhe të nënshkruaj kontratën me autoritetin kontraktues. Duke pasur parasysh faktin se në dokumentet e ofruara nga konzorciumi ankues ekziston marrëveshja që lider i grupit është OE “Company Zuka Commerce” Shpk, ndërsa personi z. Albert Bala është i autorizuar nga anëtarët e konzorciumit për dorëzimin e dosjes apo edhe për nënshkrimin e kontratës, paneli shqyrtues konsideron se duke pasur parasysh faktin se është krijuar një paqartësi lidhur me përcaktimin e liderit për grupin e OE-ve në fjalë konsiderojmë se AK me rastin e rivlerësimit duhet të sqaroj këtë fakt dhe të vërtetohet se kush është lideri i grupit të OE-ve ankues në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues ka analizuar edhe interpretimin e KRPP-së të datës 09.10.2020 në të cilin thuhet “Asnjë nga dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor nuk e ndalon që tenderi të dorëzohet nga një anëtar i konzorciumit. E rëndësishme është që tenderi të ngarkohet si grup i operatorëve ekonomik (konzorcium) në sistemin elektronik të prokurimit publik”.

Eksperti shqyrtues sqaron se me datë 04.12.2020 ka kërkuar nga grupi i OE ankues N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk, nëse AK konform vendimit të OSHP-së ka kërkuar sqarime lidhur me liderin e grupit dhe me datë 05.12.2020 nga grupi i OE ankues kam pranuar përgjigje që nga AK nuk ka pranuar asnjë kërkesë për sqarime lidhur me tenderin e tyre. Eksperti shqyrtues sqaron se bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së, çështja e liderit të grupit është shumë e qartë sepse liderin e grupit nuk e përcakton formulari i tenderit por e përcakton deklarata e themelimit të grupit dhe caktimi i liderit nga ana e anëtarëve të konzorciumit, që në këtë rast në “Akt marrëveshje bashkëpunimi” të konzorciumit shumë qartë

thuhet që lider i grupit është anëtar i konzorciumit “Company Zuka Commerce” Shpk. Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i konzorciumit ankues është i bazuar sepse AK nuk ka kërkuar sqarime bazuar në vendimin e OSHP-së lidhur me liderin e grupit të konzorciumit duke mos marrë për bazë as interpretimin e KRPP-së të datës 09.10.2020.

Përgjigje në Pretendimin 2, Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e N.N.Sh “Korben” edhe pse kjo ofertë nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, respektivisht disa pajisje nuk janë konform specifikave të kërkuara në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.426/20 i datës 28.07.2020 citoj “Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë a.) 1 eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t, b.) 2 kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 7 t d.) 1 bager deri në 10 t.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE i rekomanduar për kontratë N.N.Sh “Korben” ka dorëzuar një listë të pajisjeve që i ka në pronësi të tij se bashku me dëshmitë përcjellëse (certifikatën e regjistrimit të automjeteve dhe dokumentin unik doganor). Sipas këtyre dokumenteve është ofruar vetëm një kamion me peshë mbi 10 ton ndërsa në dosje të tenderit janë kërkuar dy kamion me peshë mbi 10 ton. Dëshmitë për cilindrata ngjeshës në këtë listë nuk janë me peshë mbi 7 ton si dhe mungon dëshmia për pajisjen bager deri në 10 ton. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe një kontratë mbi qira e mjeteve motorike me “Aim Shpk” Klinë ku janë të specifikuara të gjitha pajisjet të marra me qira. Për këto pajisje nuk janë ofruar certifikatat e regjistrimit të pajisjeve apo dokumentet unik doganor.

Disa dokumente unik doganor të dorëzuara së bashku me kontratën mbi qira të mjeteve motorike nuk dëshmojnë se janë të dhënësit të pajisjeve me qira “Aim Shpk” Klinë, por në dëshmitë e prezantuara këto pajisje janë në pronësi të N.N.T “Mirusha Transport” Shpk. Andaj ky pretendim është i bazuar”.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK gjatë fazës së rivlerësimit nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së, PSH.nr.719/20 dhe interpretimin e KRPP-së lidhur me liderin e grupit si dhe nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së 426/20 të datës 28.07.2020 duke rekomanduar për kontratë OE i cili nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të zbatoj vendimet e OSHP-së dhe kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit duke pasur në konsideratë nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues me date 17.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 17.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 24.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh "Marash-Shped" Shpk & "Company Zuka Commerce" Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar përsëri ofertën e tyre me arsyetimin se në formularin për dorëzimin e tenderit lider i grupit është OE N.T.SH "Marash Shped" Shpk, ndërsa në deklaratën e grupit është specifikuar që lideri i grupit është OE "Company Zuka Commerce" dhe pas ndryshimit të liderit sipas vlerësimit të AK-së lideri i grupit (N.T.Sh "Marash-Shped" Shpk) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca të realizuara ku është kërkuar që lideri duhet ti ketë 60 % të vlerës së kontratave të realizuara prej së paku 300,000.00 € në tri vitet e fundit, që sipas OE ankues në deklaratën për themelimin e grupit të OE shumë qartë është theksuar që lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce" Shpk dhe AK nuk ka bërë rivlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, nenit 27 të RRUOPP-së dhe vendimit të OSHP-së, PSH.nr.719/20.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.719/20 të datës 29.10.2020, ku është konstatuar "Paneli shqyrtues sqaron se pas administrimit dhe shqyrtimit të provave ka gjetur se grupi OE N.T.Sh "Marash-Shped" Shpk & "Company Zuka Commerce" Shpk së bashku më dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe Akt marrëveshjen për themelimin e grupit të OE në të cilën është specifikuar që Lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce" Shpk ndërsa OE N.T.Sh

“Marash-Shped” Shpk është anëtar i grupit. Bashkangjitur me dokumentacionin në sistemin e e-prokurimit grupi i operatorëve ekonomik kanë dorëzuar edhe një autorizim të vulosur dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e konzorciumit në të cilin është theksuar që Albert Bala (përfaqësues i anëtarit të konzorciumit N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk) autorizohet për të nënshkruar dhe dorëzuar dosjen e tenderit apo për të ofruar informata shtesë mbi atë apo nëse shpallet fitues edhe të nënshkruaj kontratën me autoritetin kontraktues. Duke pasur parasysh faktin se në dokumentet e ofruara nga konzorciumi ankues ekziston marrëveshja që lider i grupit është OE “Company Zuka Commerce” Shpk, ndërsa personi z. Albert Bala është i autorizuar nga anëtarët e konzorciumit për dorëzimin e dosjes apo edhe për nënshkrimin e kontratës, paneli shqyrtues konsideron se duke pasur parasysh faktin se është krijuar një paqartësi lidhur me përcaktimin e liderit për grupin e OE-ve në fjalë konsiderojmë se AK me rastin e rivlerësimit duhet të sqaroj këtë fakt dhe të vërtetohet se kush është lideri i grupit të OE-ve ankues në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në pajtim me nenin 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues ka analizuar edhe interpretimin e KRPP-së të datës 09.10.2020 në të cilin thuhet “Asnjë nga dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor nuk e ndalon që tenderi të dorëzohet nga një anëtar i konzorciumit. E rëndësishme është që tenderi të ngarkohet si grup i operatorëve ekonomik (konzorcium) në sistemin elektronik të prokurimit publik”.

Paneli Shqyrtues sqaron se ekspertit shqyrtues me datë 04.12.2020 ka kërkuar nga grupi i OE ankues N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk, nëse AK konform vendimit të OSHP-së ka kërkuar sqarime lidhur me liderin e grupit dhe me datë 05.12.2020 nga grupi i OE ankues kam pranuar përgjigje që nga AK nuk ka pranuar asnjë kërkesë për sqarime lidhur me tenderin e tyre. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së, çështja e liderit të grupit është shumë e qartë sepse liderin e grupit nuk e përcakton formulari i tenderit por e përcakton deklarata e themelimit të grupit dhe caktimi i liderit nga ana e anëtarëve të konzorciumit, që në këtë rast në “Akt marrëveshje bashkëpunimi” të konzorciumit shumë qartë thuhet që lider i grupit është anëtar i konzorciumit “Company Zuka Commerce” Shpk.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e N.N.Sh “Korben” edhe pse kjo ofertë nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, respektivisht disa pajisje nuk janë konform specifikave të kërkuara në dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.426/20 i datës 28.07.2020, ku është konstatuar: “Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë a.) 1 eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t, b.) 2 kamiona me konstruksion

ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 7 t d.) 1 bager deri në 10 t.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE i rekomanduar për kontratë N.N.Sh “Korben” ka dorëzuar një listë të pajisjeve që i ka në pronësi të tij së bashku me dëshmitë përcjellëse (certifikatën e regjistrimit të automjeteve dhe dokumentin unik doganor). Sipas këtyre dokumenteve është ofruar vetëm një kamion me peshë mbi 10 ton ndërsa në dosje të tenderit janë kërkuar dy kamion me peshë mbi 10 ton. Dëshmitë për cilindrata ngjeshës në këtë listë nuk janë me peshë mbi 7 ton si dhe mungon dëshmia për pajisjen bager deri në 10 ton. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe një kontratë mbi qira e mjeteve motorike me “Aim Shpk” Klinë ku janë të specifikuara të gjitha pajisjet të marra me qira. Për këto pajisje nuk janë ofruar certifikatat e regjistrimit të pajisjeve apo dokumentet unik doganor. Disa dokumente unik doganor të dorëzuara së bashku me kontratën mbi qira të mjeteve motorike nuk dëshmojnë se janë të dhënësit të pajisjeve me qira “Aim Shpk” Klinë, por në dëshmitë e prezantuara këto pajisje janë në pronësi të N.N.T “Mirusha Transport” Shpk. Andaj ky pretendim është i bazuar”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, vjen në përfundim se AK nuk e ka bërë vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nuk ka bërë vlerësimin në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. Andaj, obligohet AK që të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuri PACARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK “KOMUNA E GJAKOVËS”;

1x1 OE N.T.SH”MARASH-SHPED” & “COMPANY ZUKA COMMERCE” SHPK;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.